

Dalës-izlazna

Nr. -1- 102
Br.

Data 01.08.2023
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVË
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obilić

Në bazë të neni 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), bazuar në nenin 16, pika 1 të Ligjiit nr.04/L-174 për Planifikim Hapsinor, neni 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, të dt.25.04.2016, si dhe neni 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi Komunal pas shqyrtimit të kërkesës së DPUPK-së nr.-V-753 e datës 14.07.2023, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.07.2023, mori këtë vendim:

V E N D I M

1. Bëhet plotësim ndryshimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës me nr. nr.-I-99 i datës 30.10.2017.
2. Ndryshimi i Vendimit bëhet në nenin 2 rendi 8 dhe neni 9, ku periudha 9 (nëntë) vjeçare zëvendësohet më periudhën 8 (tetë) vjeçare.
3. Plotësim ndryshimi bëhet duke u mbështet në Ligjin nr.04/L-174 të Planifikimit Hapësinor neni 16 pika 1 ku thuhet : " Harta Zonale e Komunës është një dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimt të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare".
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjet) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës

-T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- DPUKP
- MAPL
- Arkivit

Kryesuese e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi

